



ODA E MJEKËVE TË KOSOVËS KOSOVO DOCTORS CHAMBER LEKARSKA KOMORA KOSOVA	
Njsela: Unit:	ZK
Jednica:	Mr. Prot.: 39/2018 Pr. Prot.:
Mr. I faqeve: No. of pages:	02
Pr. stranica:	Data: Datum: 04.09.2018
Prishtinë	

ODA E MJEKËVE TË KOSOVËS
KOSOVO DOCTORS CHAMBER • LEKARSKA KOMORA KOSOVA

NR. REF. 39/2018

PËR: Institucionet Private Shëndetësore
NGA: Dr. Pleurat Sejdiu, Mr. sci, Kryetar, Oda e Mjekëve të Kosovës
CC : Dr. Ardita Baraku, Kryeinspektore, Inspektorati Shëndetësor
LËNDA: Qarkore njoftuese lidhur me detyrimin për anëtarësim dhe licencim në OMK
Datë: 04 shtator 2018

Të nderuar menaxherë të Institucioneve Private Shëndetësore,

Ndonëse Oda e Mjekëve të Kosovës ka komunikuar publikisht me komunitetin e mjekëve që ushtrojnë veprimtarinë e tyre mjekësore në Republikën e Kosovës si dhe me Ju si drejtues të Institucioneve private, aktualisht vazhdon të jetë ende prezent fenomeni i neglizhencës të një grupi të mjekëve dhe Juve punëdhënës për rrespektimin e normave ligjore detyruese për anëtarësimin në OMK.

Pra, kjo neglizhencë ka të bëjë me refuzimin tanimë e konkluduar mbi detyrimin për anëtarësim në OMK edhe përkundër disa thirrjeve publike dhe personale Juve si punëdhënës, kjo edhe përkundër faktit se kanë kaluar tash e më shumë se nëntë muaj nga fillimi i procesit të regjistrimit dhe anëtarësimin në OMK, vazhdoni me avazin e mospërbushjes të një detyrim të tillë ligjor.

Madje neglizhenca lidhur me anëtarësim nuk mjafton për disa persona të papërgjegjshëm. Ndonëse sipas Vendimit të Ministrit të Shëndetësisë për validimin e licencave të skaduara deri me 30 qershor 2018, mjekët vendas, të njëjtit jo vetëm se nuk kanë kryer detyrimin lidhur me anëtarësim në OMK, por të njëjtit ushtrojnë profesionin pa licencë valide duke refuzuar rilicencimin e punës së tyre.

Poashtu, bazuar në interpretim ligjor nga ana e Zyrës ligjore të MSh-së dhe shkresës nga Sekretari i Përgjithshëm i MSh-së Dr. Naim Bardiqi, 11.06.2018, **anëtarësimi në OMK është detyrim ligjorë edhe i mjekëve shtetas të huaj para se të aplikojnë për Licencë në MSH.** Bazuar në këtë të gjitha licencat dhe vazhdimet e tyre pa u anëtarësuar në OMK, konsiderohet të pavlefshme dhe joligjore dhe veprimet e tilla përbëjnë rrezikim të shëndetit publik dhe si rrjedhojë shkelja e obligimeve të tilla tërheq pas vetes përgjegjësinë, jo vetëm administrative dhe disiplinore, por edhe atë penale. Prandaj, pas gjithë kësaj neglizhence të dokumentuar tani e sa muaj, OMK-ja përmes organeve të saj kompetente do të ndërmarr masa si të tilla:

- **Themelimi i trupave hetimore në koordinim me Prokurorinë e Odës** – Personat e autorizuar të OMK-së do të evidentojnë të gjithë mjekët, vendor dhe të huaj, të cilët nuk janë anëtarësuar si dhe mjekët të cilët ofrojnë shërbime shëndetësore pa licencë të vlefshme.
- **Inicimi i procedurës penale dhe etike-disiplinore** – Pas evidentimit të mejkëve që nuk kanë përmbushur obligimet e tyre ligjore, OMK-ja do të përgatitë kallëzimet penale që do të dorëzohen në prokuroritë kompetente për të iniciuar procedurë penale nën dyshimin e kryerjes së veprës penale të Ushtrimit të Kundërligjshëm të Veprimtarisë Mjekësore nga Neni 262 i Kodit Penal të Republikës së Kosovës. Gjithashtu ndaj mjekëve që kanë shkelur detyrimet ligjore, Prokuroria e OMK-së do të iniciojë procedurat disiplinore konform dispozitave të Ligjit për Odat e Professionistëve Shëndetësor, Statutit të Odës dhe akteve normative përkritazi me përgjegjësinë etike. Politika ndëshkimore për rastet e tilla do të bazohet në shqiptimin e gjobave në lartësi deri në 3,000.00 €, siç është paraparë me dispozitat e Nenit 25 të Ligjit për Odat e Professionistëve Shëndetësor. Barra tjetër me këtë rast do të rëndojë mbi mjekët ndaj të cilëve inicohet procedura e tillë, me evidentimin e shkeljeve të tilla etike në Regjistrin e Shkeljeve Etike pranë OMK-së.

Për të shmangur zhvillimin e procedurave që i kemi cekur më lartë, ftojmë të gjithë mjekët që nuk kanë përmbushur detyrimet e tilla ligjore, të ndërmarrin veprimet për menjanimin e shkeljeve duke u anëtarësuar në OMK dhe duke aplikuar për rilicencim në procedurë të rregullt administrative pranë organeve kompetente të OMK-së në afat prej 10 ditëve nga lëshimi i kësaj shkrese. Në të kundërtën, të gjitha veprimet që janë cekur në këtë shkresë do të jenë të zbatuara sipas planit të hartuar nga Shërbimi Profesional i OMK-së dhe sipas udhëzimeve të dhëna nga organet kompetente të OMK-së.

Për çdo sqarim, udhëzojmë të gjithë të interesuarit që të kontaktojnë Shërbimin Profesional të OMK-së.

Me respekt,

KRYETARI I OMK-SË

NR. I REF. 39 /2018 dt. 04.09.2018

Prishtinë, 04 shtator 2018

Kryetari i OMK-së
Dr. Pleurat Sejdiu, Mr.sci

